

DPK / DTP

03-4409/12

02

07.12.2012

GJL. Nr.1120/2012

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. Juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencioni Kundër Korrupsionit-Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.32185/2012 të dt. 24.09.2012, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 29.10.2012, mori

## **A K T V E N D I M**

Ankesa e paraqitur është e BAZUAR

**ABROGOHET** aktvendimi i goditur dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.32185/2012 të dt. 24.09.2012, ka shpallë përgjegjëse të pandehurën Besa Zagragja nga Prishtina, sepse si këshilltare komunale në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsion, në afatin e paraparë ligjor për vitin 2012, edhe pse ka qenë e njoftuar me kohë për këtë obligim ligjor, është vonuar deri më datën 24.07.2012 kur e ka bërë deklarin e pasurisë, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 par.1 dhe 3 nenit 9 të sanksionuar me nenin 17 par.1 dhe 3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, me nr.04/L-050, e me aplikimin e nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet, të pandehurës i është shqiptuar dënimi me Qortim. Me të njëjtin aktvendim e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 15 Euro.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve të Ligjit për kundërvajtje dhe vendimit mbi dënimin, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Thekson se e pandehura për shkak të mos deklarin të rregullt vjetor të pasurisë ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par.1.2 atë Ligjit 04/L-050, dhe se gjykata nuk i ka shqiptuar dënim meritor në pajtim me Ligjin, se deklarin i pasurisë është përgjegjësi e lartë publike dhe zbutja e dënimin në një masë të madhe bie në kundërshtim me rregullat për zbutjen e dënimin, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të njëjtës ti shqiptohet dënim meritor në pajtim me Ligjin nr.04/L-050.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklarin e dhënë të pandehurës në seancën e shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 20.09.2012, e cila e ka pranuar kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

Duke vendosur për ankesën dhe duke vlerësuar aktvendimin mbi dënimin dhe pretendimet ankimore se dënimin me Qortim është i butë dhe në kundërshtim me rregullat për zbutjen e dënimin, Kolegji vlerëson se lidhur me këtë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe drejtë, se a janë përmbushur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimin Qortim.

2,

Meqë nga shkresat e lëndës përkatësisht nga procesverbali i marrjes në pyetje shifet se është zyrtare e lartë publike dhe ka deklaruar gjendjen e mesme ekonomike, dhe ka bërë deklarin e pasurisë pas disa muajve pas inicimit të procedurës kundërvajtëse, dhe siç shifet nuk është vlerësuar shkalla e përgjegjësisë se vepra është kryer me dashje apo nga pakujdesia, që janë nga arsyerat themelore që duhet vlerësuar me rastin e vendosjes për shqiptimin e dënimit. Andaj pretendimi ankimor se në rastin konkret nuk janë vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, është i bazuar.

Gjykata e shkallës së parë është bazuar vetëm në deklaratën e dhënë të pandehurës, ndërsa prova tjera nuk janë administruar, se në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftuara për arsyen e zbutjes së dënimit të pandehurës me aplikimin 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet. Andaj për këto arsye Kolegji vlerëson se aktvendimi i goditur nuk mund të qëndrojë dhe është abroguar që në plotësim të procedurës gjykata e shkallës së parë duhet të marrë në pyetje përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës, i cili duhet të deklarohet lidhur me kundërvajtjen të cilën i vë në barrë të pandehurës, që ka të bëjë me deklarin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë, ndërsa në ankesë thirrë në kundërvajtje nga neni 6 par.1.2 të Ligjit nr.04/L-050, që ka të bëjë me deklarin e rregullt vjetor. Sipas nevojës të administrohen edhe prova të tjera e pastaj pas vlerësimit të gjitha rrethanave dhe vërtetimit të gjendjes faktike të nxjerrë aktvendim të ri duke pas për bazë edhe thëniet e paraqitura në ankesën e organit kompetent Agjencionit Kundër Korrupsionit, e pastaj të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtëse.


Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

**GJL. Nr. 1120/2012 të dt. 29.10.2012.**

**SEK. JURIDIKE**  
Sanije Salihu



**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
Ramiz Kuqi